




INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

ZYRA E KRYEMINISTRIT  
URED PREMIJERA  
OFFICE OF THE PRIME MINISTER

SEKRETARI I PËRHERSHËM  
STALNI SEKRETAR  
PERMANENT SECRETARY



**Për:** Ministrat e Qeverisë së Kosovës  
**Nga:** Fitim KRASNIQI, Sekretar i Përhershëm në Zyrën e Kryeministrit  
**Kopje:** Sekretarët e përhershëm të ministrive  
**Lënda:** **Vendimet e mbledhjes së tretë të Qeverisë së Kosovës**  
**Datë:** 23.01.2008

Të nderuar,

Ju dërgojmë vendimet nga mbledhja e tretë e Qeverisë së Kosovës e mbajtur më 22 janar 2008.

Bashkangjitur me këtë shkresë keni materialet e sipërshënuara.

Me nderime!



INSTITUCIONET E PËRKOZHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:01/3

Datë: 22.01.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes 2-të dhe i transkriptit të mbledhjes së 1-të të Qeverisë, me vërejtjen e ministrit Ahmet Shala në procesverbal, në faqen e 4-të pika 5 e rendit të ditës në rreshtin 4,5 dhe 6.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

*for* **Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:02/3  
Datë: 22.01.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të gjithë të emëruarit politikë qeveritar; Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat, zëvendësministrat dhe këshilltarët politikë të përcaktohen për një pagë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.
2. Të emëruarit politikë nga pika një e vendimit duhet të heqin dorë nga pagat e dyfishta, nëse janë deputetë të Kuvendit të Kosovës apo anëtarë të bordeve dhe komisioneve me pagesë të emëruar nga qeveria dhe kuvendi.
3. Obligohet Ministria e Shërbimeve Publike për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 3/2004 dhe në afat 15 ditor t'ia paraqesë Qeverisë për miratim.
4. Ngarkohen Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe sekretaret e përhershëm të ministrive për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

*For* Kryeministri i Kosovës  
**Hashim THAÇI**





INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:03/3  
Datë: 22.01.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të rishikohen të gjitha vendimet e marra nga ish Qeveria, pas datës 17 nëntor 2007.
2. Të rishikohen të gjitha vendimet e marra nga ish Qeveria për emërimë dhe punësim të stafit politik, si dhe të anëtarëve të bordeve të ndryshme, pas datës 17 nëntor 2007.
3. Të rishikohen të gjitha vendimet e marra nga ish Qeveria për punësime stafit civil, në ministritë dhe agjencionet, pas datës 17 nëntor 2007.
4. Për vendimet e punësimit të bëra në kundërshtim me dispozitat ligjore pas konstatimit të ndërmerren veprimet përkatëse ligjore.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha ministritë/sekretarët e përhershëm.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

*fos* Kryeministri i Kosovës  
Hashim THAÇI



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA


Numër:04/3  
Datë: 22.01.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të gjitha automjetet zyrtare të Qeverisë të shfrytëzohen vetëm për nevoja zyrtare, sipas Nenit 4 pika 4.2 të Udhëzimit Administrativ, nr. 07/2006.
2. Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, Sekretari i Përhershëm i ZKM-së dhe shefi i kabinetit të Kryeministrit do të kenë në përdorim 24 orë automjetet zyrtare për qëllime zyrtare.
3. Automjetet të përdoren edhe nga zyrtarët tjerë gjatë orarit të punës për nevoja zyrtare me fletë udhëtime.
4. Automjetet që shfrytëzohen për udhëtime zyrtare jashtë vendit do të përdoren në pajtim me nenin 4 pika 4.3 të Udhëzimit Administrativ, nr. 07.2006.
5. Për shpenzimet e karburanteve, të mirëmbajtjes si dhe të shpenzimeve tjera të respektohen dispozitat e neneve 7, 8 ,9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2006.
6. Autorizohet Ministria e Shërbimeve Publike që të bëjë projektin e detajuar për përdorimin, furnizimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe pas verifikimit të gjendjes së automjeteve të vendoset për shitjen përmes ankandit publik ose dhënien në përdorim institucioneve tjera.
7. Mjetet e kursyera nga zvogëlimet e shpenzimeve nga përdorimi i automjeteve zyrtare do të destinohen për shpenzime tjera (sociale), ndërsa ato nga shitja e automjeteve përmes ankandit publik do të destinohen për shpenzime kapitale.







INSTITUCIONET E PËRKOQSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

8. Ky vendim vlen edhe për organizatat tjera buxhetore: kuvendet komunale (MAPL autorizohet për mbikëqyrjen e këtij procesi nëpër komuna), SHPK (MPB), TMK (MSHP), gjykata (MD) dhe ndërmarrjet publike (MEF, MTPT, MEM, MTI).
9. Për moszbatimin e këtij vendimi ndaj personave përgjegjës do të merren masa administrative, disiplinore nga ministrat.
10. Të fillohet procedura nga ana e Ministrisë së Shërbimeve Publike për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, nr. 07/2006 në përputhje me këtë vendim dhe t'ia paraqesë Qeverisë për miratim.
11. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e Kryeministrit, ministritë/ sekretarët e përhershëm të gjitha ministrive.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

 **Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**  




INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:05/3  
Datë: 22.01.2008


Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të drejtë në telefon roming do të kenë: Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat, zëvendësministrat, Sekretari i Përhershëm i ZKM-së si dhe shefi i kabinetit të Kryeministrit.
2. Shpenzimet nga telefonat roming, në shumë mujore, përcaktohen si më poshtë:
  - Kryeministri pa kufizim
  - Zëvendëskryeministrat deri në 250,00 Euro
  - Ministrat deri në 250,00 Euro
  - Zëvendësministrat deri në 150,00 Euro
  - Sekretari i Përhershëm i ZKM-së deri në 150,00 Euro
  - Shefi i kabinetit të Kryeministrit deri në 150,00 Euro
3. Këshilltarët politikë të Kryeministrit, të zëvendëskryeministrave, të ministrave, të zëvendësministrave, si dhe shefat e kabineteve të zëvendëskryeministrave dhe ministrave kanë të drejtë në mbushje të telefonave mobilë sipas nenit 10 pika 10.5 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ, nr. 08/2006.
4. Obligohen të gjitha ministrat që të sjellin raportet mujore në Qeveri për shpenzimet e telefonave.
5. Të fillohet procedura nga Ministria e Shërbimeve Publike për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, nr. 08/2006 në përputhje me këtë vendim dhe t'ia paraqesë Qeverisë për miratim.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e Kryeministrit, ministrat/ sekretarët e përhershëm të të gjitha ministrive.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

 **Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**





INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:06/3  
Datë: 22.01.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të hartohet rregullorja për caktimin e shpenzimeve të reprezentacionit për institucionet e Qeverisë së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Shërbimeve Publike për hartimin e aktit sipas pikës një të vendimit dhe në afat 15 ditor t'ia paraqesë Qeverisë për miratim
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

*Per* **Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**





INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:07/3  
Datë: 22.01.2008


Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori


**V E N D I M**

1. Formohet Grupi Punues Qeveritar për të punuar në dhënien e rekomandimeve finale në afat prej 15 ditëve, për zbrazëtirat ligjore të Rregullorës së UNMIK-ut 2007/30 për ndryshimin e Rregullores 2000/45 "Mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës";
2. Grupi i Punues Qeveritar ka këtë përbërje:
  - Sekretari i Përhershëm i MAPL-së, Kryesues
  - Sekretari i Përhershëm i MSHP anëtar;
  - Sekretari i Përhershëm i MEF-it anëtar;
  - Sekretari i Përhershëm i MD anëtar;
  - Kryetari i Komunës së Prishtinës, anëtar;
  - Kryetari i Komunës së Pejës, anëtar;
  - Kryetari i Komunës së Mitrovicës anëtar; dhe
  - Drejtori i Departamentit Ligjor të MAPL-së, anëtar
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal/ Sekretari Përhershëm .
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

  
**Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT

QEVERIA E KOSOVËS  
GOVERNMENT OF KOSOVO  
VLADA KOSOVA

Numër:08/3  
Datë: 22.01.2008


Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 janar, mori

**V E N D I M**

1. Të gjithë të emëruarit politikë qeveritar; Kryeministri, Zëvendëskryeministri, ministrat, zëvendësministrat dhe këshilltarët politikë nuk mund të jenë anëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike/ të kenë poste të dyfishta, përveç rasteve të parashikuara me ligj.
2. Ngarkohen Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe sekretarët e përhershëm të ministrive për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të Zyrës së Kryeministrit
- Arkivit të Qeverisë

 **Kryeministri i Kosovës**  
**Hashim THAÇI**  
